


MALI I ZI
KOMUNA E GUCISË
Sekretariati për administratë të
përgjithshme dhe veprimtari
shoqërore
Numër: 02 – 4746
Guci, 06.10.2025.



Adresa: Carsijska nr.28
84326 Guci, Mali i Zi

Tel/fax: +382 51 250 157

E-mail: opstauprava@opstinagusinje.me

Web portal: www.opstinagusinje.me

Bazuar në nenin 71 pika 8 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 002/18, 034/19, 038/20, 050/22, 084/22, 081/25, 098/25), nenin 9 paragrafi 1 pika 6 të Vendimit për organizimin dhe mënyrën e funksionimit të pushtetit lokal të Komunës së Gucisë ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi - Rregulloret Komunale", Nnr. 055/23) dhe Vendimit për bursimin e studentëve të Komunës së Gucisë ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi - Rregulloret komunale" " , nr. 004/18 dhe 003/20), Sekretariati për Administratë të përgjithshme dhe veprimtari Shoqërore i Komunës së Gucisë, shpallë:

KONKURS

për ndarjen e bursave studentore për vitin akademik 2025/26

Të drejtën për bursë mund ta ushtrojnë studentët e rregullt, të cilët:

- Kanë shtetësi malazeze,
- Kanë vendbanim në Komunën e Gucisë,
- Sipas planprogramit të institucionit të arsimit të lartë ku studiojnë, kanë të kaluar vitin paraprak të studimit me notën mesatare mbi 8.50 dhe të paktën 90% të kredive ECTS.
- Janë regjistruar për herë të parë në semestrin e vitit akademik,
- Nuk kanë përsëritur asnjë vit gjatë studimeve të tyre,
- Nuk janë të punësuar,
- Nuk janë më të vjetër se 25 vjeç.

Për shkak të mungesës së kadrove deficitar, jepet **bursë e posaçme** për studimet në **Mjekësi, Arkitekturë, Ndërtimtari dhe Bujqësi.**

Të drejtën për bursë të posaçme mund ta ushtrojnë studentët që plotësojnë kushtet e përgjithshme të përcaktuara në Vendimin për bursa studentore në Komunën e Gucisë dhe të cilët, sipas planprogramit të institucionit të arsimit të lartë ku studiojnë, kanë dhënë provimet nga viti i kaluar i studimit me notë mesatare mbi 7.50 dhe të paktën 90% të kredive ECTS.

Të drejtë për bursë të posaçme për vitin e 1-rë të studimeve kanë edhe nxënësit të cilët kanë fituar Diplomën "Pishtari" ("Luča"), nëse mënjherë pas përfundimit të shkollës së mesme janë regjistruar në studimet deficitare: Mjekësi, Arkitekturë, Ndërtimtari apo Bujqësi.

Përfituesit e bursës së posaçme janë të detyruar që pas përfundimit të studimeve t'i kryejnë punët në territorin e Komunës, sipas sistemit: një vit bursë- një vit pune në territorin e Komunës së Gucisë.

Kandidati që aplikon për bursë duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- Vërtetim të vendbanimit,
- Vërtetim për regjistrimin e vitit të studimit,
- Vërtetim për provimet e dhëna të vitit të kaluar,
- Vërtetim të shumës së kredive të fituara ECTS,
- Vërtetim të notës mesatare,
- Dëshmi (deklaratë) që nuk është i punësuar dhe
- Dëshmi (deklaratë) që studentin nuk përfiton bursë tjetër.

Të drejtë bursimi do të kenë **6 (gjashtë)** studentët e renditur më mirë (studentët me notën mesatare më të mirë të vitit të kaluar).

Konkursi është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në faqen e Komunes së Gucisë <https://www.opstinagusinje.me>, pra duke përfunduar më **14.11.2025**.

Të interesuarit mund të marrin formularin e aplikimit për ushtrimin e të drejtës së bursës në byronë e Komunes, i cili është i publikuar edhe në faqen e internetit të Komunes.

SHËNIM: Aplikimet e pakompletuara dhe të arritura pas afatit dhe në të cilat nota mesatare e vitit të kaluar nuk është e definuar qartë, nuk do të merren parasysh!

Të gjitha dokumentet e lartpërmendura dorëzohen në zarf të mbyllur në byronë e Komunes së Gucisë me shënimin: "**Aplikim në konkursin për për ndarjen e bursave studentore për vitin akademik 2025/26**".

VD SEKRETARJA
Alina Sehovic

